



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 05-400-37140 /15
Kaçanik, 30.10.2015

Në bazë të nenit 40.2(b) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 34.5 dhe 61 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 56 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 30 tetor, 2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË BUXHETIT TË KOMUNËS
PËR PERIUdhËN, JANAR-SHTATOR, 2015

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti financiar me Nr. 01Nr. 05-400-37140/15, me tekstin e mëtejme “ Raporti i Buxhetit të Komunës, për periudhën: janar-shtator 2015”, i hartuar nga Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/ L-048.
2. Në Raportin Vjetor të përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi janë prezantuar Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme të Buxhetit të Përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut, për periudhën 01.01.2015-30.09.2015, i përmbledhur në gjithsej 17 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, si dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

